
Besnikëria e vërtetë ndaj atdheut



Hazret Mirza Masroor Ahmed
Udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia

Rreth autorit



Hazret Mirza Masroor Ahmedi, është Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar dhe udhëheqësi shpirtëror i miliona muslimanëve ahmedianë që jetojnë në më shumë se 200 vende të botës. Në këtë pozitë ai u zgjodh në vitin 2003.

Jeta e tij është pasqyrim i dedikimit, qëndrueshmërisë, lutjes dhe suksesit. Lidhja e tij me Zotin e nxit atë për t'i udhëhequr anëtarët e Xhematit të tij që mos të harrojnë kurrë të Plotfuqishmin e as mos të humbasin shpresë. Përqendrimi i tij në lutje dëshmohet nga të gjithë ndërsa frytet dhe suksesi i lutjeve të tij vërtetojnë besimin dhe bindjen e tij. Dashamirësia e tij ndaj njerëzimit e nxit atë dhe Xhematin e tij për t'i shërbyer njerëzimit me të njëjtin shpirt, me të cilin u shërbyen muslimanët e hershëm të varfërve dhe nevojtarëve.

Ai shquhet për veprimtarinë e tij për të promovuar paqen në mbarë botën. Gjithashtu ai nxit që njerëzit ta njohin Krijuesin e tyre dhe t'u shërbejnë krijesave të Tij. Për këtë, ai shpesh takon liderë dhe njerëz të çdo shtrese të vendeve të ndryshme, qoftë në Lindje apo në Perëndim, qoftë në Jug apo në Veri të botës. Përveç takimeve, ai u drejtohet besimtarëve muslimanë çdo të premte përmes fjalimit të tij të xhumasë, fjalim i cili, transmetohet drejtpërdrejt në mbarë botën, përmes tri kanaleve televizive të Xhematit Musliman Ahmedia.

Xhemati qëndron krah për krah me Kalifin e tij në përmendjen e Allahut dhe shërbimin ndaj njerëzimit.

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

Gëzuar 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë

Parathënie

Atdhedashuria është një ndjenjë e pastër shpirtërore që gjendet thellë në natyrën e çdo njeriu. Vendi ku lind ai, ku hap sytë, loz me dheun e tij, rritet nga ushqimet që nxjerr ai dhé, kalon stinët e jetës bashkë me ato të vendit, për të ai bëhet si nënë dhe natyrisht, dashuria ndaj tij shkrihet në gjakun e tij. Nëse atdhedashuria shfaqet në formën e duhur te njeriu, ajo mund të kultivojë tek ai vlera e virtyte të larta, e të kontribuojë për mbarësinë, jo vetëm të kombit, por të gjithë njerëzimit.

Por, a lind vetvetiu dashuria ndaj atdheut në natyrën e njeriut apo i paraprin asaj diçka?! Çfarë është atdheu për dikë?, dhe, çka është ajo që i bën njerëzit ta duan atdheun? Atdheu, në radhë të parë, është pasuri, pasuri që duhet ruajtur. E ajo pasuri është e gjithanshme: familje, gjuhë, veshje, kulturë etj. Që të gjitha këto formojnë vlerë, e cila lind një dashuri të natyrshme ndaj atdheut. Kush më pak e kush më shumë orientohet nga resurset që e mbushin zemrën e tij për dashuri e besnikëri ndaj atdheut.

Ndërsa besimi u jep formën dhe përmbajtjen e duhur ndjenjave dhe dëshirave njerëzore. Ai e plotëson njeriun duke ndërgjegjësuar sjelljen e

tij dhe e pajis atë me vetëdije hyjnore, që ai të ruhet nga rreziqet që mund t'i shkaktojë vet. Kur atdhedashuria mishërohet me besimin në një Krijues, shfaqet në formën më të hijshme, duke sjellë vlera dhe dobi të gjithanshme. Por, fatkeqësisht po bëhen përpjekje për të ngushtuar kuptimin e saj, dhe sot ajo përqaset me nacionalizëm, shovinizëm dhe urrejtje ndaj racave, kombeve apo shteteve të tjera. Historia e botës na tregon raste të panumërta të konflikteve të përgjakshme ndëretnike që kishin zanafillën pikërisht në të kuptuarin e të shtrembër të kësaj ndjenjeje.

Më shumë do atdheun apo fenë?! Pyetje që kemi dëgjuar sa e sa herë, sidomos nga njerëz, të cilët me krenari iu janë drejtuar besimtarëve për t'i vënë në sprovë para një debati poshtërues ose përqeshës. Një krahasim i tillë i fesë dhe i atdheut as që do të duhej të bëhej. Për më tepër të dyja janë kaq të mishëruara në qenien e një njeriu, saqë nuk di se si shihen ndaras.

Në këtë broshurë paraqesim një ndër fjalimet e Hazret Mirza Masroor Ahmedit, Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, në të cilin ai shpjegon rëndësinë dhe kuptimin e vërtetë të besnikërisë ndaj atdheut dhe trajton disa pika interesante që mund të lindin në mendjen e njerëzve kur e shohin atdhedashurinë me prizmin fetar.

Në kuadër të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, po ju përcjellim mesazhin e tij, me dëshirë që vlerat e besimit na nxitin për të kontribuuar në progresin dhe zhvillimin e vendit, për një të ardhme të sigurt dhe të begatshme.

Zoti ju bekoftë. Zoti e bekoftë Shqipërinë. *Amin*

Shahid Ahmad Butt
President i Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë

Besnikëria e vërtetë ndaj atdheut

Fjalim i Hazret Mirza Masroor Ahmedit, Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, Kryetarit botëror të Xhematit Musliman Ahmedia, i mbajtur në Qendrën Ushtarake të Koblenzit të Gjermanisë, më 30 maj, të vitit 2012

Bismillahirrahmanirrahim, Në emër të Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Es-selam alejkum ue rrahmatullahi ue barrakatuhu, Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Së pari, do të doja të shfrytëzoja rastin që t'ju falënderoj gjithë ju që më ftuat në qendrën tuaj dhe më dhatë mundësi të ndaj disa fjalë me ju. Si kryetar i Xhematit Musliman Ahmedia, dëshiroj t'ju paraqes mësime të Islamit. Por, kjo është një temë kaq e gjerë, saqë është e pamundur ta përmbledh atë në një takim apo në një kohë të shkurtër. Andaj, më duhet ta kufizoj temën vetëm rreth një aspekti të Islamit, që ta fokusoj atë dhe të flasë rreth tij.

Ndërkohë që po mendoja se cilin aspekt ta shtjelloj në fjalimin tim, mora një kërkesë nga Kryetari i Xhematit Musliman Ahmedia të Gjermanisë, i nderuar Abdullah Wagishauser, që unë të flas rreth mësimeve të Islamit në lidhje me dashurinë dhe besnikërinë e një personi ndaj atdheut të tij. Kjo më ndihmoi që të bëja zgjedhjen time. Prandaj, do të flas shkurtimisht rreth disa mësimeve të Islamit lidhur me këtë.

NË KËTË KONTEKST, NJË PYETJE QË MUND TË LINDË NË MENDJEN E NJERËZVE ËSHTË QË, BESNIKËRIA E NJË MUSLIMANI NDAJ SHTETIT DHE ZOTIMI I TIJ PËR TË RESPEKTUAR LIGJET E VENDIT MOS KANË RËNDËSI DYTËSORE TEK AI DHE PËR KËTË ARSYE, VALLË, A DO TË SAKRIFIKOJË AI ZOTIMIN E TIJ NDAJ SHTETIT NË DISA RASTE?

Është shumë e lehtë të flasësh apo të dëgjosh për "besnikërinë dhe dashurinë e një personi ndaj atdheut të tij". Megjithatë, këto pak fjalë përfshijnë kuptime shumë të gjera, të bukura dhe të thella. Padyshim, të perceptosh dhe të kuptosh tërësisht atë që këto fjalë përcaktojnë dhe atë që na kërkojnë, është me të vërtetë shumë e vështirë. Sidoqoftë, kohën e shkurtër që kam në dispozicion, do të përpiqem t'ju shpjegoj konceptin e Islamit për besnikërinë dhe dashurinë e një personi ndaj atdheut të tij.

Parimi i parë dhe më themelori i fesë Islame është që fjalët e një personi dhe veprat e tij kurrsesi nuk duhet të tregojnë hipokrizi apo standarde të dyfishta. Besnikëria e vërtetë kërkon një lidhje të ndërtuar në bazat e sinqeritetit dhe ndershmërisë. Ajo kërkon që edhe nga brenda njeriu të jetë i njëjtë me atë që shfaqet në sipërfaqe. Në marrëdhëniet me shtetin, ky parim ka rëndësi të madhe. Prandaj, është thelbësore për një shtetas, të cilitdo shtet, të vendosë një lidhje besnikërie të çiltër ndaj shtetit të tij, pa marrë parasysh nëse ai është qytetar i lindur i atij shteti apo fiton shtetësinë gjatë jetës së tij përmes rrugës së imigracionit apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Besnikëria është një veti madhore dhe njerëzit që kanë shfaqur këtë veti në shkallën më të lartë ishin profetët e Zotit. Dashuria dhe besnikëria e tyre ndaj Zotit ishin aq të fuqishme, saqë në çdo çështje ata i ndoqën porositë e Tij dhe u munduan tërësisht për t'i zbatuar ato, pavarësisht nga rrethanat. Kjo tregon nënshtrimin e tyre ndaj Tij si dhe standardet e tyre të përsosura të besnikërisë. Ndaj, pikërisht standardet e tyre të besnikërisë ne duhet t'i marrim si model për vete. Megjithatë, para se të shtoj diçka, është e nevojshme të kuptojmë se çfarë do të thotë *besnikëri* në të vërtetë.

Sipas mësimeve të Islamit, përkufizimi apo kuptimi i vërtetë i besnikërisë është që një person duhet në mënyrë të pastër t'i përmbushë të gjitha zotimet dhe premtimet e tij në të gjitha nivelet dhe në të gjitha rrethanat, pavarësisht nga vështirësitë që has në mes. Ky është standardi i vërtetë i besnikërisë që kërkon Islami. Në shumë *ajete* të Kuranit Famëlartë, Allahu

QË TË KESH DASHURI
TË VËRTETË NDAJ ZOTIT DHE
NDAJ ISLAMIT, KËRKON QË TË
KESH DASHURI EDHE NDAJ
ATDHEUT. PRA, ËSHTË SHUMË
E QARTË QË NUK MUND
TË KETË ASNJË KONFLIKT
INTERESI MIDIS DASHURISË
SË NJË PERSONI NDAJ ZOTIT
DHE DASHURISË SË TIJ NDAJ
ATDHEUT.

urdhëron muslimanët që ata duhet të përmbushin zotimet dhe premtimet e tyre, sepse do të merren në përgjegjësi nga Ai për të gjitha ato. Muslimanët janë urdhëruar të përmbushin të gjitha marrëveshjet, duke përfshirë edhe ato që ata kanë bërë me Zotin e Madhërishëm, si dhe zotimet e tjera që kanë bërë, në bazë të shkallës së tyre të rëndësisë.

Në këtë kontekst, një pyetje që mund të lindë në mendjen e njerëzve është që, besnikëria e një muslimani ndaj shtetit dhe zotimi i tij për të respektuar ligjet e vendit mos kanë rëndësi dytësore tek ai dhe për këtë arsye, vallë, a do të sakrifikojë ai zotimin e tij ndaj shtetit në disa raste? Ka mundësi të krijohet kjo përshtypje, sepse muslimanët pohojnë që Zoti dhe feja e Tij kanë rëndësinë më të madhe për ta, që do të thotë se zotimi i tyre i besnikërisë ndaj Zotit është prioriteti i tyre i parë dhe se atë zotim ata e vlerësojnë mbi gjithçka dhe mundohen ta përmbushin atë.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, së pari dua t'ju informoj që Profeti Muhammed s.a.v.s. vetë na ka mësuar që *"Dashuria ndaj atdheut është pjesë e besimit"*. Ndaj, patriotizmi i sinqertë është një kërkesë e Islamit. Që të kesh dashuri të vërtetë ndaj Zotit dhe ndaj Islamit, kërkon që të kesh dashuri edhe ndaj atdheut. Pra, është shumë e qartë që nuk mund të ketë asnjë konflikt interesi midis dashurisë së një personi ndaj Zotit dhe dashurisë së tij ndaj atdheut. Përderisa dashuria ndaj atdheut është përcaktuar si pjesë e Islamit, është shumë e qartë atëherë që një musliman duhet të orvatet për të arritur standardet e larta të besnikërisë ndaj vendit të tij, sepse edhe ky është një mjet për ta arritur Zotin dhe për t'iu afruar Atij. Prandaj, është e pamundur që dashuria e një muslimani të vërtetë ndaj Zotit të mund të bëhet pengesë që e ndalon atë për të shprehur dashurinë dhe besnikërinë e vërtetë ndaj shtetit të tij. Fatkeqësisht, në disa shtete shohim që të drejtat fetare ngushtohen madje mohohen tërësisht. Prandaj, një pyetje tjetër që mund të ngrihet është që qytetarët e një shteti të caktuar, në të cilin ata persekutohen nga shteti i tyre, a mund të vazhdojnë të kenë raport dashurie dhe besnikërie ndaj vendit apo shtetit të tyre? Me shumë pikëllim dua t'ju them që të njëjtat rrethana ekzistojnë në Pakistan, ku qeveria praktikisht ka

vënë ligje kundër Komunitetit tonë. Këto ligje anti-ahmediane praktikisht imponohen. Në Pakistan, të gjithë muslimanët ahmedianë zyrtarisht nga ligji janë deklaruar "jo-muslimanë". Për këtë arsye, ahmedianët atje janë të ndaluar të quajnë veten muslimanë. Ata gjithashtu janë të ndaluar të adhurojnë në mënyrën siç adhurojnë muslimanët e tjerë, ose të ndjekin cilëndo praktikë që i identifikon ata si muslimanë. Kështu që, në Pakistan vetë shteti i ka provuar anëtarët e Xhematit tonë nga e drejta elementare e njeriut për fenë.

Duke e marrë parasysh këtë gjendje, është e natyrshme të mendosh se në këto rrethana si muslimanët ahmedianë mund të zbatojnë ligjet e vendit? Si ata mund të shfaqin besnikëri ndaj shtetit? Këtu dua të sqaroj që kur ekzistojnë situata kaq ekstreme, atëherë ligji dhe besnikëria ndaj vendit bëhen dy çështje të ndara. Ne muslimanët ahmedianë besojmë se feja është një çështje personale e çdo individi dhe se nuk duhet të ketë imponim në çështjet e saj. Prandaj, aty ku ligji ndërhyn në këtë të drejtë, padyshim ai bëhet një akt me dhunë dhe persekutim i ashpër. Dihet që persekutimet e tilla shtetërore, që janë bërë gjatë kohërave të ndryshme, janë dënuar nga shumica e njerëzve.

Nëse do t'i hedhim një vështrim historisë së Evropës, shohim që edhe në këtë kontinent disa popuj kanë qenë viktimë të persekutimit fetar, dhe si rrjedhojë disa mijëra njerëz u detyruan të mërgojnë nga një vend në një vend tjetër. Të gjithë historianët, qeveritë dhe njerëzit mendjendritur janë të mendimit që ky persekutim i përkiste një dhune të skajshme. Në rrethana të tilla, Islami udhëzon, që aty ku persekutimi kapërcen çdo kufi dhe ai bëhet i padurueshëm, atëherë njeriu duhet të largohet nga ai qytet apo shtet për të mërguar në ndonjë vend ku është i lirë të praktikojë paqësisht fenë e tij. Gjithsesi, përveç këtij udhëzimi, Islami gjithashtu mëson që në asnjë rrethanë asnjë individ nuk duhet të marrë vetë ligjin në dorë dhe as nuk duhet të marrë pjesë në projekte dhe komplote kundër vendit të tij. Ky është një urdhër shumë i qartë dhe i shkoqur i dhënë nga Islami.

Pavarësisht nga persekutimi i egër që po përballen ata, miliona

ahmedianë vazhdojnë të jetojnë në Pakistan. Pavarësisht se ata po bëhen shënjestër e një diskriminimi dhe dhune të tillë të pareshtur në çdo aspekt të jetës së tyre, ata vazhdojnë të kenë lidhje të besnikërisë dhe devotshmërisë absolute ndaj atdheut të tyre. Në cilëndo fushë punojnë ose kudo që të jenë vendosur, ata vazhdimisht janë të angazhuar për t'i ardhur në ndihmë vendit për progresin dhe suksesin e tij. Për dekada me radhë, kundërshtarët e ahmedianëve kanë tentuar të pretendojnë se ahmedianët nuk janë besnikë ndaj Pakistanit, por ata kurrsesi nuk arritën ta provojnë këtë ose të tregojnë ndonjë dëshmi në mbështetjen e pohimit të tyre. Përkundrazi, e vërteta është që çdoherë kur lindi nevoja për të bërë ndonjë sakrificë për hir të Pakistanit, për hir të vendit, muslimanët ahmedianë gjithmonë u gjendën në rreshtin e parë dhe gjithmonë u treguan të gatshëm për të dhënë çdo sakrificë.

Pavarësisht se muslimanët ahmedianë janë viktimë dhe shënjestër e ligjit, pikërisht janë ata që zbatojnë ligjin e shtetit më mirë se kushdo tjetër. Kjo është për arsye se ata janë muslimanë të vërtetë, që ndjekin Islamin e vërtetë. Një tjetër mësim që ka dhënë Kurani Famëlartë në lidhje me besnikërinë është që njerëzit duhet të heqin dorë nga çdo gjë që është e paturpshme, padëshirueshme dhe rebele. Një tipar i bukur dhe i dalluar i Islamit është që ai jo vetëm na tërheq vëmendjen për pasojat përfundimtare, ku ato mund të jenë mjaft të rrezikshme, por ai na alarmon edhe për të gjitha çështjet e vogla, të cilat veprojnë si shtigje për të drejtuar njerëzimin në rrugën e hapur të rrezikut. Kështu që, nëse udhëzimi i Islamit do të ndiqet ashtu siç duhet, atëherë çdo problem mund të zgjidhet që në fillim, para se situata të dalë jashtë kontrollit.

Për shembull, një çështje që mund të dëmtojë rëndë një shtet është babëzia e individëve për para. Shpesh njerëzit pushtohen tërësisht nga dëshirat materiale, aq sa ato u bëhen të pafrenueshme dhe dëshirat e tilla përfundimisht i shpien drejt një sjelljeje të pabesë. Këto gjëra, përfundimisht shkaktojnë një tradhti ndaj shtetit. Më lejoni t'ju sqaroj pak. Në arabisht, është përdorur fjala *"bagia"*, për të përshkruar personat apo sjelljet e tyre,

SIPAS MËSIMEVE TË ISLAMIT, ZOTI I MADHËRISHËM KA NDALUAR TË GJITHA FORMAT E PABESISË DHE TË REBELIMIT, QOFSHIN KUNDËR SHTETIT TË TYRE APO TË QEVERISË. KJO SEPSE REBELIMI OSE VEPRIMI KUNDËR SHTETIT KËRCËNON PAQEN DHE SIGURINË E VENDIT.

që i sjellin dëm shtetit. Bëhet fjalë për ata që marrin pjesë në aktivitete të gabuara ose që dëmtojnë të tjerët. Ajo gjithashtu nënkupton ata njerëz që bëjnë mashtrime, përpiqen të zaptojnë gjërat në një mënyrë të padrejtë e të paligjshme dhe që shkelin të gjithë kufijtë dhe në këtë mënyrë shkaktojnë dëm dhe humbje. Islami mëson që nga njerëzit që ndjekin këto rrugë nuk mund të shpresohet që ata të tregojnë besnikëri, sepse besnikëria është e gërshetuar me virtytet e larta. Besnikëria nuk mund të ekzistojë pa vlerat e larta morale dhe vlerat e larta morale nuk mund të ekzistojnë pa besnikëri. Ndonëse, është e vërtetë që njerëz të ndryshëm mund të kenë pikëpamje të ndryshme për standarde të larta morale, megjithatë, feja Islame vërtitet tërësisht rreth kërkimit të pëlqimit të Zotit. Kështu që, muslimanët janë urdhëruar të veprojnë gjithnjë për ta kënaqur Atë. Shkurt, sipas mësimeve të Islamit, Zoti i Madhërishëm ka ndaluar të gjitha format e pabesisë dhe të rebelimit, qofshin kundër shtetit të tyre apo të qeverisë. Kjo sepse rebelimi ose veprimi kundër shtetit kërcënon paqen dhe sigurinë e vendit. Madje, aty ku ndodh kryengritje apo kundërshtim i brendshëm, ai patjetër i fryn zjarrit të kundërshtimit të jashtëm duke inkurajuar të huajt të përfitojnë nga çrregullimi i brendshëm. Prandaj, pasojat e pabesisë ndaj shtetit mund të jenë shumë të mëdha dhe ekstreme. Kështu që, çdo gjë që mund ta dëmtojë shtetin përfshihet në termin *"bagia"*, që sapo ju kam shpjeguar. Duke marrë parasysh të gjitha këto gjëra, besnikëria ndaj shtetit i kërkon njeriut që të tregohet i duruar, i virtytshëm dhe zbatues i ligjeve të vendit.

Në përgjithësi, në epokën moderne, shumica e qeverive drejtohen në mënyrë demokratike. Prandaj, nëse ndonjë person apo grup dëshirojnë të ndryshojnë qeverinë, atëherë ata duhet të bëjnë një gjë të tillë duke ndjekur procesin e duhur demokratik. Zërin e tyre ata duhet të përcjellin përmes kutive të votimit. Votat nuk duhet të jepen në bazë të preferencave apo interesave personale, përkundrazi, Islami na mëson që çdo person duhet të japë votën e tij me një ndjenjë besnikërie dhe dashurie ndaj vendit të tij. Çdo person duhet të japë votën e tij duke menduar për përmirësimin e shtetit të tij. Prandaj, askush nuk duhet të shikojë prioritetet personale dhe se nga cili kandidat apo parti ai mund të ketë përfitim personal, përkundrazi, ai

NË VARGUN 59 TË KAPITULLIT 4 TË KURANIT FAMËLARTË, ALLAHU KA URDHËRUAR QË NJERIU DUHET T'U LËRË BESIMIN E TIJ ATYRE QË MERITOJNË DHE SE NË GJYKIMIN E TIJ NDAJ NJERËZVE, AI DUHET TË MARRË VENDIMIN ME DREJTËSI DHE SINQERITET. PRANDAJ, BESNIKËRIA NDAJ VENDIT I KËRKON NJERIUT QË AI T'UA DORËZOJË PUSHTETIN ATYRE QË ME TË VËRTETË E MERITOJNË ATË, NË MËNYRË QË SHTETI TË KETË PROGRES DHE TË DALË PËRPARA NDËR VENDET E BOTËS.

duhet të marrë vendimin e tij drejtësisht duke vlerësuar se cili kandidat apo cila parti do t'i vijë në ndihmë progresit kombëtar. Çelësat e qeverisë janë një besim shumë i madh, ndaj ato duhet t'i lësh në duart e një partie për të cilën beson sinqerisht që është më e përshtatshmja dhe më e merituara.

Ky është Islami i vërtetë dhe kjo është besnikëria e vërtetë.

Në *ajetin* (vargun) 59 të *suresë* (kapitullit) 4 të Kuranit Famëlartë, Allahu ka urdhëruar që njeriu duhet t'u lërë besimin e tij atyre që meritojnë dhe se në gjykimin e tij ndaj njerëzve, ai duhet të marrë vendimin me drejtësi dhe sinqeritet. Prandaj, besnikëria ndaj vendit i kërkon njeriut që ai t'ua dorëzojë pushtetin atyre që me të vërtetë e meritojnë atë, në mënyrë që shteti të ketë progres dhe të dalë përpara ndër vendet e botës.

Në shumë vende të botës, shohim që disa njerëz marrin pjesë në greva dhe protesta kundër politikave të qeverisë. Madje, në disa vende të Botës së Tretë, protestuesit sabotojnë dhe dëmtojnë pronat dhe pasuritë që i përkasin shtetit ose qytetarëve të tij. Megjithëse ata mund të deklarojnë që akti i tyre është nga dashuria, por e vërteta është që aktet e tilla nuk kanë të bëjnë fare me besnikërinë apo dashurinë ndaj vendit. Duhet të kemi parasysh që edhe atje ku protestat ose grevat organizohen në mënyrë paqësore, pa shkaktuar dhunë apo dëmtim kriminal, prapëseprapë ato mund të sjellin pasojë shumë negative. Sepse, edhe protestat paqësore shpesh rezultojnë në humbjen e disa milionave për ekonominë e shtetit. Sjellje të tilla, në asnjë rrethanë, nuk mund të konsiderohen si një shembull i besnikërisë ndaj shtetit. Një parim i artë që është dhënë nga Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia është që në çdo rrethanë, ne duhet t'i qëndrojmë besnikë Allahut, profetëve dhe udhëheqësve të shtetit. Ky është i njëjti mësim që është dhënë në Kuranin Famëlartë. Pra, edhe atje, ku shteti lejon organizimin e grevës dhe protestave, ato duhen organizuar vetëm deri në masën që nuk sjellin dëm apo humbje shtetit ose ekonomisë së tij.

Një tjetër pyetje që shpesh ngrihet është që muslimanët a mund të shërbejnë në forcat ushtarake të vendeve perëndimore, dhe nëse po, a

NJË TJETËR PYETJE QË
SHPESH NGRIHET ËSHTË
QË MUSLIMANËT A MUND
TË SHËRBEJNË NË FORCAT
USHTARAKE TË VENDEVE
PERËNDIMORE, DHE NËSE PO,
A MUND TË MARRIN PJESË
NË NDONJË SULM USHTARAK
KUNDËR SHTETEVE ISLAMIKE?

mund të marrin pjesë në ndonjë sulm ushtarak kundër shteteve islamike? Një parim themelor është që asnjë person nuk duhet të marrë pjesë në aktet e barbarisë, parim të cilin, çdo musliman duhet të ketë si parësor në mendjen e tij. Nëse një shtet islamik sulmohet, për arsye se ai vetë ka vepruar në mënyrë të dhunshme dhe të padrejtë dhe është ai që ka marrë nismën për agresion, atëherë në rrethana të tilla, Kurani udhëzon qeveritë muslimane që ato ta ndalojnë dorën e tiranit. Kjo do të thotë që ato duhet të ndalojnë dhunën dhe të mundohen për të vendosur paqe. Kështu që, në rrethana të tilla lejohen të merren masa që janë mjet për t'i dhënë fund dhunës. Megjithatë, nëse shteti që ka shkelur kufijtë, e reformon veten dhe përvetëson paqen, atëherë ai dhe qytetarët e tij nuk duhet të shfrytëzohen me pretendime dhe justifikime false. Madje, duhet që atyre t'u mundësohet liri dhe pavarësi që gëzon një shtet normal. Pra, synimet ushtarake duhet të jenë për të vendosur paqe, e jo për të përmbushur interesa të ulëta.

Në të njëjtën mënyrë, Islami u jep të gjitha shteteve, qofshin muslimane apo jo, të drejtën për të ndaluar dhunën dhe tiraninë. Prandaj, nëse është e nevojshme, shtetet jo islamike mund të sulmojnë shtetet islamike për t'i arritur këto synime të sinqerta. Muslimanët që jetojnë në ato vende jo-muslimane lejohen të marrin pjesë në ushtritë e shteteve të tyre për të parandaluar shtetin tjetër nga dhuna. Atje ku me të vërtetë ekzistojnë rrethana të tilla, atëherë ushtarët muslimanë, në cilëndo ushtri perëndimore të bëjnë pjesë, duhet të zbatojnë urdhrat dhe të luftojnë, nëse nevojitet, për të vendosur paqe. Por, nëse një ushtri, duke u treguar tirane, merr një vendim të padrejtë për të sulmuar shtetin tjetër, atëherë një musliman ka opsionin për t'u larguar nga ushtria, sepse në këtë rast ai do të përkrahë dhunën. Duke marrë këtë vendim, nuk do të thotë që ai tregohet jo besnik ndaj vendit të tij. Në të vërtetë, në rrethana të tilla, besnikëria ndaj vendit të tij i kërkon që ai të marrë një hap të tillë e të këshillojë qeverinë e tij që ajo të mos lejojë veten të bjerë aq poshtë siç kanë rënë ato qeveri dhe shtete të padrejta që vepruan në mënyrë barbare. Por, nëse pjesëmarrja në ushtri është e domosdoshme dhe nuk ka rrugëdalje për t'i ikur asaj, dhe atë e bren ndërgjegjja, atëherë ai duhet të largohet nga vendi i tij, por nuk duhet të

ÇDOLLOJ BESNIKËRIE
DUHET TË LIDHET ME
BESNIKËRINË NDAJ ZOTIT.
NËSE DO TË NDODHË KJO,
ATËHERË ME SYTË TANË
DO TË DËSHMOJMË TEK
NJERËZIT E TË GJITHA
VENDEVE NIVELET MË TË
LARTA TË BESNIKËRISË
DHE DO TË HAPEN RRUGËT
MË TË REJA QË NA ÇOJNË
DREJT PAQES DHE SIGURISË
NË MBARË BOTËN.

ngrejë zërin kundër ligjit të shtetit. Ai duhet të largohet sepse një musliman nuk lejohet të jetojë në një vend si shtetas i tij, dhe njëkohësisht të veprojë kundër tij apo t'u bashkohet kundërshtarëve.


Këto janë disa aspekte të mësimeve të Islamit, që udhëzojnë të gjithë muslimanët e vërtetë për kërkesat e vërteta të besnikërisë dhe dashurisë ndaj shtetit. Në kohën që kisha në dispozicion, unë vetëm kam arritur ta prek përmbledhtas këtë temë.

Në fund, dua të them që në këtë kohë vërejmë që bota është bërë si një fshat global. Njerëzimi është bashkuar dhe i gërshetuar. Popujt e të gjitha kombeve, feve dhe kulturave gjenden në të gjitha shtetet. Kjo kërkon që liderët e çdo vendi duhet të vlerësojnë dhe respektojnë ndjenjat dhe mendimet e të gjithë njerëzve. Liderët e qeverive të tyre duhet të mundohen për të hartuar ligje, që krijojnë atmosferë dhe frymë të vërtetësisë dhe drejtësisë, e jo të krijojnë ligje që përdoren si mjet për të tensionuar dhe irrituar njerëzit. Padrejtësitë dhe egërsitë duhet të eliminohen dhe në vend të tyre duhet të mundohemi për të vendosur drejtësinë e vërtetë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është që bota të arrijë ta njohë Krijuesin e saj. Çdolloj besnikërie duhet të lidhet me besnikërinë ndaj Zotit. Nëse do të ndodhë kjo, atëherë me sytë tanë do të mund të dëshmojmë tek njerëzit e të gjitha vendeve nivelet më të larta të besnikërisë dhe do të hapen rrugët më të reja që na çojnë drejt paqes dhe sigurisë në mbarë botën.

Para së të përfundoj, dua t'ju falënderoj të gjithë ju edhe një herë për ftesën dhe vëmendjen tuaj. Zoti ju bekoftë gjithë ju dhe Zoti e bekoftë Gjermaninë. Shumë faleminderit.

Përktheu: Samad Ghori

Redaktuan: Muhamet Peci, Rexhep Hasani



Hazret Mirza Masroor Ahmed duke mbajtur fjalim në Qendrën Ushtarake të Koblenzit



Gjeneral Brigade Bach duke i dhuruar një pikturë Kalifit V të Mesihut të Premtuar



Gjeneral Brigade Bach me Hazret Mirza Masroor Ahmedin përpara flamurit gjerman



Adresat:

Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë,
Rr. Pavarësia, KM 1, Mëzez,
Kutia Postare 8176,
Tiranë, Shqipëri (Albania)

Kontakt +355(0) 682055780, (0)695876901; (0)662994966

darulfalah@gmail.com

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës
Rr. "Holger Pedersen", Lagja e Spitalit, Prishtinë
Kontakt: +37744628679

www.alislam.al

Xhemati Musliman Ahmedia

Xhemati Musliman Ahmedia është një bashkësi muslimane, e themeluar nga Hazret Mirza Ghulam Ahmedi a.s. Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu (1835-1908) në Indi, në vitin 1889. Sot ky Xhemat gjendet në më shumë se 200 vende të botës me dhjetëra miliona anëtarë. Ahmedianët besojnë në të gjitha parimet e Islamit. Ata besojnë në Kuranin Famëlartë, në Profetin Muhammed s.a.v.s. dhe të gjitha dispozitat që burojnë prej tyre. Megjithatë, ata dallohen nga grupe të tjera muslimane në botëkuptimin e disa profecive që lidhen me ditët e vona.



Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s.
Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Muslimanët ahmedianë dallohen nga grupe të tjera muslimane gjithashtu për shkak se Xhemati i tyre është i vetmi xhemat në Islam që gëzon sistemin e Kalifatit, sistemi ky që u vendos pas vdekjes së Ghulam Ahmedit a.s.. Deri më tani pesë Kalifët e tij, njëri pas tjetrit e udhëhoqën Xhematin dhe u angazhuan tërësisht në përmbushjen e misionit të përhapjes së Islamit. Sot, nën udhëheqjen e Kalifit të pestë Hazret Mirza Masroor Ahmed, ky Xhemat gjendet në më shumë se 200 vende të botës, ka botuar Kuranin në më shumë se 70 gjuhë të botës, ka ndërtuar mijëra xhami, qindra spitale dhe shkolla anë mbanë botës. Tashmë Xhemati transmeton mesazhin e tij në gjuhë të ndryshme të botës përmes tri kanaleve satelitore MTA, si dhe nëpërmjet internetit www.alislam.org. Xhemati gjithashtu ka një organizatë humanitare Humanity First, e cila kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ofron ndihma në çdo rast fatkeqësie, sidomos në vendet e varfra. Këto shërbime humanitare, Xhemati Musliman Ahmedia i bën vetëm për të fituar pëlqimin e Zotit, sepse sipas fesë Islame, ata që nuk përmbushin detyrimet ndaj krijesave të Zotit, nuk mund t'i përmbushin detyrimet as ndaj Zotit. Andaj, slogani i këtij Xhemati është *"Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd"*.

DASHURI
PËR TË GJITHË
URREJTJE
PËR ASKËND

www.alislam.al

Albanian translation of the address of Hadhrat Khalifatul Masih V [aba], on the topic of *"True Loyalty to One's Nation"*, delivered at the Military Headquarters in Koblenz, Germany, on 30th May 2012.